

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

Korçë, me 21.02.2023

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : **Bashkise Maliq**

Per: shtetasin : Xhensila Feto, me adrese Blloku nr. 1
Nd. 20 Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil
nr. 77 dt. 30.01.2023 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi
me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e komunikimit
eshte kthyer me shenimin : " I panjohur " dhe pas afishimit
kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne
gjykate.



U afishua sot ne date -----
Per Bashkine Maliq
Nepunesi _____
(emer, mbiemer, firme)

- S. tel. informacionit.
dt 24.02.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr.Regj.Them. 21001-01809-41-2022(722/1498)
Data e regjistrimit 07.12.2022

Nr. vendimi 41-2023-266 (77)
Datë vendimi 30.01.2023

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e përbërë nga:

GJYQTARE - Gentiana Shukullari

asistuar prej sekretares gjyqësore Brilda Hoxhallari, në Korçë, sot në datë 30.01.20221, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kërkesën civile me nr. regj. themel. 21001-01809-41-2022(722/1498), që i përket:

PADITËS:

Erjon Feto i biri i Pellumbit dhe Suzanës i dtl. 07.03.1985, lindur dhe banues në Maliq, në adresën: Blloku nr. 1, Nd. 20.

E PADITUR:

Khensila Feto e bija e Osmanit dhe Tatjanës, e dtl. 10.03.1992, lindur në Rëmenj Pogradec dhe banuese në Maliq, në adresën: Blloku nr. 1, Nd. 20, përfaqësuar nga av. Budion Hoxha, anetar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI:

Zgjidhja e martesës ligjore. Rregullimin e pasojave që vijnë prej saj.

BAZA LIGJORE:

Neni 34, 41, 51, 154 e 349 i K. Pr. Civile, neni 132 e vijues i K.Familjes.

Në përfundim të gjykimit, i cili u zhvillua në mungesë të paditësit dhe në prani të të paditurës e përfaqësuesit të saj av. Budjon Hoxha, gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, administroi provat, dëgjoi pretendimet e fundit të të paditurës dhe përfaqësuesit të saj, të cilët kërkuan pranimin e padisë dhe çmoi provat në tërësi,

Analiza gjyqësore e kërkuar do të bazohet në dispozitat e Kodit të Familjes që disiplinon martesën, detyrimet që rrjedhin prej saj dhe zgjidhjen e martesës.

Në themel të këtij gjykimi qëndron kërkuar për zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur në datën 02.08.2021 midis paditësit Eryon Feto dhe të paditurës Xhendila Feto.

Gjykata pas analizës së faktit të sipërcituar, pretendimeve të palës paditëse dhe

Vlerësimi i gjykatës.

E paditura në seancën e pajtimit parashtrori se ishte njohur me të paditurin nëpërmjet vazhdojë në marrëdhënia e tyre. Kishite ardhur për herë të fundit në Shqipëri, nuk kishite pranuar të shkonte në shtëpinë e saj, por i kishite kërkuar të shkonte në Tiranë. Në kushtet kur ai nuk ka më besim tek ajo, edhe ajo ishte dakord që martesë të zgjidhej.

E paditura në seancën e pajtimit parashtrori se ishte njohur me të paditurin nëpërmjet vazhdojë në marrëdhënia e tyre. Kishite ardhur për herë të fundit në Shqipëri, nuk kishite pranuar të shkonte në shtëpinë e saj, por i kishite kërkuar të shkonte në Tiranë. Në kushtet kur ai nuk ka më besim tek ajo, edhe ajo ishte dakord që martesë të zgjidhej.

Nga parashtrimet e bëra në kërkesëpadi dhe shpjegimet e dhëna në seancën e pajtimit, këto kushte, kaloi gëshjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Gjykata bazuar në nenet 134 dhe 135 të Kodit të Familjes, zhvilloi seancën e pajtimit bashkia Maliq, nga kjo martesë nuk kanë ardhur në jetë fëmijë.

Paditësi Eryon Feto dhe e paditura Xhensila Feto, kanë lidhur martesë në datën 02.08.2021 në Maliq, referuar certifikatës së martesës datë 06.12.2022, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 238, Njësia Administrative Maliq, bashkia Maliq, referuar certifikatës familjare 06.12.2022 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 238, Njësia Administrative Maliq, bashkia Maliq, referuar certifikatës bashkia Maliq, nga kjo martesë nuk kanë ardhur në jetë fëmijë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi e provuar se:

Gjykata e vendit ku kanë vendbanimin e fundit të përbashkët bashkëshortët. "a" e K. Pr. Civile, si dhe nga pikpamja tokësore bazuar në nenin 51 të K. Pr. Civile, si Gjyqësor Korgë është kompetente nga pikpamja lëndore bazuar në nenin 41 e 349 shkronja gjyqësor, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Paraprakisht, gjykata konstatoi se kjo mosmarrëveshje bën pjesë në juridiksionin padinë me objekt: "Zgjidhjen e martesës ligjore. Rregullimin e pasqajave që vijnë prej saj."

Pala paditëse Eryon Feto i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korgë, me

Neni 1 parashikon: "Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit".

Neni 50 parashikon: "Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime. Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës".

Neni 51 parashikon: "Bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet.

Neni 54 parashikon: "Në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesa nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre."

Neni 55 parashikon: "Bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët. Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës, e cila, pasi dëgjon mendimet e të dy bashkëshortëve dhe, nëse është rasti, edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mundohet të arrijë një zgjidhje me mirëkuptim. Kur kjo nuk është e mundur, gjykata vendos zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për kërkesat e familjes."

Neni 123 parashikon: "Martesa mbaron me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës së tyre".

Neni 132 parashikon: "Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët".

Referuar përcaktimeve të nenit 1 të Kodit të Familjes, martesa cilësohet si një shfaqje e vullnetit të dy personave për të krijuar një marrëdhënie juridike të caktuar, nga e cila lindin të drejta dhe detyrime për palët. Nëpërmjet kësaj marrëdhënie bashkëshortët kanë si qëllim kryesor të krijojnë një familje, të jetojnë së bashku dhe të solidarizohen në interesat e njëri-tjetrit. Në momentin që ata nuk kanë më qëllimin për jetesë të përbashkët apo të solidarizohen për mirëqenien materiale, emocionale të njëri tjetrit, të kenë respekt dhe mirëkuptim reciprok, atëherë martesa ka humbur qëllimin e saj kryesor.

Zgjidhja e martesës përbën instrumentin ligjor nëpërmjet të cilit i jepet fund marrëdhënies familjare që buron nga martesa. Ligjvënësi, duke dashur të mbrojë veçanërisht martesën për shkak të natyrës *sui generis* të saj, ka legjitimuar në Kodin e Familjes, neni 123, vetëm tre raste nëpërmjet të cilave mund t'i jepet fund një marrëdhënie të tillë.

Shkaqet e zgjidhjes së martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, janë parashikuar në mënyrë orientuese në nenin 132 të Kodit të Familjes, duke mos përjashtuar dhe shkaqe të

tjera, që rasti pas rasti mund të paraqiten në marrëdhëniet bashkëshortore që çojnë në berjen të pamundur të jetesës së përbashkët.

Në rastin konkret, paditësi Eryon Feto ka legjitimitet aktiv dhe interes juridik të ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi prej saj varet lindja e të drejtave me karakter personal dhe pasuror, të tilla si: ndryshim i gjëndjes civile nga i martuar në i shkurorëzuar; e drejta për të lidhur martesë tjetër ligjore, pjesëtimi i pasurisë. Pala e paditur gëzon legjitimitet pasiv, në cilësinë e bashkëshortes së paditësit me të cilin ka lindur mosmarrëveshja familjare objekt gjyqimi.

Përsa më sipër, gjykata gmon se martesë e ka humbur qëllimin e saj për paditësin por edhe për të paditurën, duke mbetur thjesht formale. Midis bashkëshortëve ka patur mungesë mirëkuptimi, grindje e mosmarrëveshje, të cilat kanë ardhur duke u shtuar nisur dhe nga fakti që jetojnë larg njëri - tjetrit. Paditësi jeton në SHBA, ndërsa e paditura në Pogradec. Qëllimi i lidhjes së tyre ka qenë jetesa e përbashkët në SHBA. Në kushtet kur midis palëve mungon besimi reciprok, ata nuk dëshirojnë më të kenë një marrëdhënie bashkëshortore me njëri - tjetrin. Ata jetojnë të veçuar dhe nuk mbështesin njëri-tjetrin si moralisht, emocionalisht, ashtu dhe materialisht. Nga sa më sipër janë shkelur detyrimet që rrjedhin nga martesë, të përcaktuara në nenin 50, 54, 55 të K. Familjes. Gjatë gjyqimit rezultoi se këto detyrime nuk janë respektuar, pasi midis palëve ka munguar bashkëpunimi e mirëkuptimi, veçanërisht në kushtet që bashkëshortët kanë kohë që nuk kanë marrëdhënie normale, pasi paditësi jeton në SHBA dhe ka ndërprerë takimet e rregullta me të paditurën, e cila jeton në Pogradec, Shqipëri.

Në kushtet kur gjykata konkludon për zgjidhjen e martesës, ajo ka detyrimin ligjor të shprehë edhe për zgjidhjen e pasojave që vijnë për bashkëshortët dhe fëmijët.

Lidhur me pasojat për bashkëshortët, parashikuar në nenet 147-153 të K. Familjes.

Gjykata gmon se nuk ka vend për t'u shprehur lidhur me to, përsa kohë nga e paditura nuk u ngritën pretendime për kontribut apo të drejtën e përdorimit të banesës.

E vetmja kërkesë e parashtruar lidhur me këto pasoja, ishte ndryshimi i mbiemrit të të paditurës nga "Feto" në atë paramartesor "Kugo". Në kushtet kur e paditura ka marrë mbiemrin e bashkëshortit dhe nuk kërkoj mbajtjen e tij, bazuar në nenin 146 paragrafi i parë K. Familje, gjykata gmon se ky kërkim është i bazuar dhe si i tillë duhet pranuar.

Nga kjo martesë, ashtu siç u provua më lart, nuk kanë ardhur në jetë fëmijë, nuk ka vend për rregullimin e pasojave lidhur me ta.

Në këto kushte, përsa më sipër, gjykata gmon se padia është e bazuar në ligj dhe në prova, dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, të parapagunara nga paditësi, në mbështetje të nenit 102 dhe 106 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata gmon se duhet të lihen sig janë kryer, pasi pala paditëse nuk kërkoj disponimin ndryshe për to.

Bazuar në nenet 143 dhe 144 të Kodit të Familjes, pasi vendimi të ketë marrë formë të prërë, duhet t'i dërgohet për regjistrim Zyres së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Maliq, bashkia Maliq, për të bërë ndryshimet përkatëse në regjistrat.

Meqënëse vendimi nuk përmban detyrime, nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk jemi në kushtet e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit sipas përcaktimeve të neneve 510, 511 të K. Pr. Civile.

PER KËTO ARSYE


Gjykata bazuar në nenin 132 e vijues të Kodit të Familjes si dhe në nenet 126 dhe 306-310 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pranimin e padisë së palës paditëse Erjon Feto.
2. Zgjidhjen e martesës së lidhur në datën 02.08.2021, midis paditësit Erjon Feto dhe të paditurës Xhensila Feto.
3. Pas zgjidhjes së martesës, e paditura Xhensila, merr mbiemrin paramartesor Kuqo.
4. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer.
5. Një kopje e këtij vendimi, pasi të ketë marrë formë të prerë, t'i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile, Njësia Administrative Maliq, bashkia Maliq.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, me datë 30.01.2023.

SEKRETARE
Brilda HOXHALLARI



GJYQTARE
Gentiana SHUKULLARI



SHKURTËSIA

09 FEB 2023

